

MIRATOHET

KRYETARI I GJYKATËS SË LARTË

XHEZAIR ZAGANJORI

RREGULLORE E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË GJYQTARËVE

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Votimit dhe për procesin e votimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

Neni 2 Baza ligjore

Miratimi i kësaj Rregullore bazohet në pikën 7 të nenit 16 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Neni 3 Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve

1. Në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve marrin pjesë të gjithë magjistratët e emëruar si gjyqtarë dhe që kryejnë funksionet e gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët e komanduar që mbajnë ende statusin e magjistratit dhe që shërbejnë për një kohë të caktuar në strukturat e tjera shtetërore, si dhe të gjithë gjyqtarët që janë me leje sipas ligjit, me kusht që në ditën e votimit në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve nuk kanë mbushur moshën e pensionit. Gjyqtarët e pezulluar nga organet e rivlerësimit, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo me vendim gjyqësor, nuk mund të marrin pjesë dhe as të votojnë në këtë mbledhje.

2. Kryetari i Gjykatës së Lartë i kërkon KLGJ në kohën e duhur që të hartojë dhe t'i verë në dispozicion listën emërore të magistratëve sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni.

Neni 4

Drejtimi i Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve

Kryetari i Gjykatës së Lartë drejton punimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve. Në mungesë të tij ky funksion ushtrohet nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë. Kur Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve është thirrur me nismën e 1/10 të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, ajo drejtohet nga njëri prej gjyqtarëve nismëtarë, i zgjedhur nga vetë gjyqtarët nismëtarë.

Neni 5

Kuorumi

1. Para fillimit të punimeve të Mbledhjes së Përgjithshme, nën kujdesin e administratës së Gjykatës së Lartë, çdo gjyqtar regjistrohet, kundrejt nënshkrimit, në listën e regjistrimit të gjyqtarëve të përgatitur sipas listës së hartuar nga KLGJ.

2. Drejtuesi i Mbledhjes, pasi verifikon dhe sigurohet për ekzistencën e kuoromit të nevojshëm, i përcaktuar nga neni 14/2 i ligjit nr. 115/2016, vijon me zhvillimin e punimeve të Mbledhjes të Përgjithshme të Gjyqtarëve (kuorumi konstitutiv përbëhet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve).

Neni 6

Sigurimi i transparencës

1. Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, në të gjitha fazat e saj, është e hapur për mediat dhe të gjithë vëzhguesit që shprehin interes për ta ndjekur.

2. Kandidatët për anëtarë të KLGJ mund të caktojnë vëzhgues që autorizohen paraprakisht nga Kryetari i Gjykatës së Lartë për të ndjekur procesin.

3. Administrata e Gjykatës së Lartë pajis me fletëhyrje vëzhguesit pasi verifikon pajisjen me autorizimin paraprak nga Kryetari i Gjykatës së Lartë të të interesuarve.

4. Nuk kanë nevojë për autorizim Ministri i Drejtësisë ose një person i autorizuar prej tij dhe 2 anëtarë të komisioni të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend.

KREU II

ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË VOTIMIT

Neni 7

Komisioni i votimit

1. Për zhvillimin e procedurës së votimit dhe shpalljen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të KLGJ, sipas nenit 16/4 të ligjit nr. 115/2006, krijohet Komisioni i Votimit, i përbërë nga 3 ndihmësmagjistratë, të zgjedhur me short ndërmjet ndihmësmagjistratëve të Gjykatës së Lartë.

2. Nën përgjegjësinë e Drejtuesit të Mbledhjes së Përgjithshme, shorti për zgjedhjen e Komisionit

të Votimit zhvillohet në ambientet e Gjykatës së Lartë jo më vonë se 2 ditë nga data e thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme. Gjatë zhvillimit të shortit, me ftesë të Drejtuesit të Mbledhjes së Përgjithshme, marrin pjesë si vëzhgues Avokati i Popullit, një anëtar i Komisionit për monitorimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë. Procedura e zhvillimit të shortit pasqyrohet në një procesverbal i cili në nënshkruhet nga Drejtuesi i Mbledhjes, vëzhguesit e pranishëm dhe sekretari i ngarkuar për hartimin e tij.

3. Kur ndihmës magjistratët e Gjykatës së Lartë janë vetëm 3 në numër, ata janë automatikisht anëtarë të Komisionit të Votimit.

4. Në rast se numri i ndihmagjistratëve të Gjykatës së Lartë është i pamjaftueshëm për të krijuar Komisionin e Votimit, për percakimin e përbërjes së tij realizohet një short me pjesëmarrjen e përbashkët të ndihmagjistratëve në detyrë si dhe ish magjistrateve të komanduar në Gjykatën e Lartë për tre vitet e fundit që nuk janë kandidatë.

5. Komisioni i Votimit zgjedh nga radhët e tij Kryetarin e tij me marrëveshje. Në rast mosmarrëveshje organizohet short.

Neni 8

Zhvillimi i shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Votimit

1. Procedura e zhvillimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Votimit realizohet nepërmjet tërheqjes së goglave të futura në një kuti transparente. Numri total i goglave në kuti duhet të përputhet me numrin e ndihmësmagjistratëve të Gjykatës së Lartë.

2. Në presence të të gjithë pjesëmarrësve, një nga punonjësit e administratës së Gjykatës së Lartë i caktuar nga Drejtuesi i Mbledhjes, fut fillimisht nëpër gogla shiritat e letrës që përmbajnë emrat e ndihmësmagjistratëve të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 7 të Rregullores, dhe më pas i vendos ato të gjitha brenda në kuti.

3. Më pas, një punonjës tjetër, i caktuar nga Drejtuesi i Mbledhjes, tërheq goglën nga kutia dhe pasi e hap atë, lexon me zë të lartë emrin e anëtarit të Komisionit që përmban shiriti i letrës dhe ia tregon të gjithë pjesëmarrësve. Tërheqja e goglave bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme, aq sa është numri i anëtarëve të Komisionit të Votimit.

KREU III

PROCEDURA E VOTIMIT TË ANËTARËVE TË KLGJ

Neni 9

Prezantimi i Komisionit të Votimit

Përpara zhvillimit të procedurës së votimit, Drejtuesi i Mbledhjes prezanton anëtarët e Komisionit të Votimit dhe i fton ata që të afrohen në vendin ku do të zhvillohet votimi.

Neni 10

Prezantimi i listës së kandidatëve

1. Drejtuesi i Mbledhjes prezanton listën e kandidatëve sipas shkallëve të gjyqësorit si dhe numrin e vendeve vakante për çdo shkallë.

2. Kur gjyqtari, i cili në kohën e zgjedhjeve nuk ka qenë caktuar në një pozicion në një gjykatë të caktuar, paraqet kandidaturën për anëtar të KLGJ, pozicioni i tij i fundit përcaton shkallën për të cilën ai kandidon.

Neni 11 **Prezantimi i platformës nga kandidatët**

1. Cdo kandidat ka të drejtë të paraqesë platformën personale të qëllimeve dhe objektivave që propozon të ndjekë për përmirësimin e sistemit gjyqësor në shërbim të qytetarëve, në qoftë se zgjidhet anëtar i KLGJ.
2. Përpara fillimit të procedurës së votimit, Drejtuesi i Mbledhjes fton çdo kandidat që është i pranishëm për të prezantuar platformën.
3. Prezantimi i kandidatëve bëhet në rend alfabetik për çdo shkallë, duke filluar nga gjykata më e lartë.
4. Prezantimi për çdo kandidat është jo më shumë se 5 minuta.
5. Platforma e secilit kandidat preferohet të paraqitet e përmbledhur dhe kandidati shumëfishon dhe vë në dispozicion të pjesëmarrësve kopje të mjaftueshme, të cilat shpërndahen nga administrata e Gjykatës së Lartë përpara fillimit të Mbledhjes së Përgjithshme.

Neni 12 **Shpjegimi i rregullave të votimit**

Kryetari i Komisionit të Votimit u shpjegon shkurtimisht gjyqtarëve votues, duke përdorur edhe mjetet e teknologjisë së informacioni kur është e volitshme, rregullat për menyrën sesi ata duhet të votojnë, referuar, sipas rastit, nivelit të gjyqësorit, numrit të kandidatëve dhe përkatësisë së gjykatës së kandidatit.

Neni 13 **Përmbajtja e fletës së votimit**

1. Votimi bëhet duke përdorur fletën e votimit të miratuar paraprakisht nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.
2. Fleta e votimit përmban elementet e mëposhtëm:
 - a) Numri rendor i kandidatit.
 - b) Emri dhe Mbiemri i plotë i kandidatit (renditja e kandidatit do të bëhet sipas rendit alfabetik duke iu referuar emrit).
 - c) Gjykata ose institucioni ku kandidati kryen funksionin e tij si magjistrat.
 - ç) Vendin e posaçëm për votim.
 - d) Një shënim në fund të fletës së votimit ku renditen shkaqet ligjore të pavlefshmërisë së votës.

Neni 14 **Procedura e votimit**

1. Pas shpjegimeve të rregullave të votimit, Komisioni i votimit vijon me procedurën e votimit të

kandidaturave për anëtarë të KLGJ.

2. Anëtarët e komisionit të votimit nënshkruajnë të gjitha fletët e votimit. Anëtarët e komisionit të votimit nënshkruajnë një numër fletësh votimi të barabartë me numrin e gjyqtarëve të pranishëm në Mbledhjen e Përgjithshme.

3. Komisioni i Votimit i dorëzon çdo gjyqtari fletën e votimit kundrejt nënshkrimit në listën e votuesve.

4. Çdo gjyqtar i regjistruar në listën e regjistrimit të Mbledhjes së Përgjithshme ka të drejtën e vetëm një vote. Nuk lejohet votimi me përfaqësim.

5. Gjyqtarët votues paraqiten me radhë pranë Komisionit të Votimit. Një nga anëtarët e Komisionit të Votimit fton gjyqtarët e pranishëm për të votuar, duke filluar nga gjykata më e lartë.

6. Anëtarët e Komisionit të votimit votojnë në fund të procesit të votimit.

7. Gjyqtarët votues duhet të ndjekin rregullat e votimit si vijon:

- a) votohet vetëm në fletët apo fletët e bashkalidhura të vëna në dispozicion nga Komisioni i Votimit. Nëse fletët e bashkalidhura nuk përmban numrin e saktë të fletëve të dhëna nga Komisioni, të gjitha fletët e tjera dhe fletët e gjetura të veçuara, do të jenë të pavlefshme dhe nuk do të numërohen si vota;
- b) fletët e votimit hidhen në kutitë e votimit të cilat janë të veçanta për secilën shkallë gjykate që kandidohet;
- c) votohet duke vendosur në kutinë përbri emrit të kandidatit njërën nga shenjat “+” ose “x” ose “ō”. Në fletën e votimit të mos bëhen shënime të tjera përveç shenjës së votimit, pasi çdo shënim tjetër e bën votën të pavlefshme;
- ç) ka vetëm një votë për fletë votimi. Asnjë kandidat nuk mund të votohet më shumë se një herë nga i njëjti gjyqtar, pasi kjo votë do të jetë e pavlefshme dhe nuk do të numërohet.

8. Pavlefshmëria e konstatuar në një fletë votimi, e bën të pavlefshme votën për atë fletë votimi, por nuk shtrihet në fletët e tjera të votimit të bashkalidhura.

9. Nëse nga gjykatat e apelit dhe nga gjykatat e shkallës së parë jashtë Tiranës, ka vetëm nga një kandidat respektivisht për pozicionet që i janë rezervuar kandidatëve jashtë Tiranës (sipas nenit 7 të Ligjit “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”), votimi do të zhvillohet vetëm me një fazë.

Për Gjykatën e Lartë do të votohet vetëm në një fletë votimi ku do të listohen të gjithë kandidatët.

Për gjykatat e apelit, votimi do të mbahet, sipas rastit, në një ose dy fletë votimi të bashkangjitura, një me emrin e kandidatit të vetëm jashtë Tiranës, dhe tjetra me kandidatin/ët nga Tirana.

Për gjykatat e shkallës së parë, votimi do të mbahet, sipas rastit, në një ose më shumë fletë votimi të bashkangjitura, një me emrin e kandidatit të vetëm jashtë Tiranës, dhe fleta/ët e tjera me të gjithë kandidatët nga Tirana, me qëllim për të garantuar që në fletën/ët votimi të votohet vetëm për një kandidat (sipas nenit 17 (2) (c) të Ligjit “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”).

10. Nëse nga gjykatat e apelit ose nga gjykatat e shkallës së parë jashtë Tiranës, ka më shumë se një kandidat respektivisht për pozicionet që i përkasin kandidatëve jashtë Tiranës (sipas nenit 7 të Ligjit “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”), votimi do të zhvillohet me dy faza. Faza e parë e votimit do të zgjedhë përfaqësuesin e gjykatave jashtë Tiranës. Në këtë rast, nëse do të zgjidhen kandidatë edhe nga Gjykata e Lartë, zgjedhja e tyre do të mbahet gjatë fazës së

pare. Pas shpalljes së rezultateve të votimit, do të zhvillohet faza e dytë e votimit. Në fazën e dytë, do të votohen të gjithë kandidatët e gjykatave të vendosura si në Tiranë dhe ato jashtë Tiranës, me përjashtim të kandidati fitues të fazës së parë.

Neni 15

Pavlefshmëria e votës

1. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
 - a) fleta e votimit nuk ka të njëjtat elemente të miratuara nga Komisioni i Votimit;
 - b) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatëve;
 - c) është votuar për më shumë se një nga kandidatët;
 - ç) nuk është votuar për asnjë nga kandidatët;
 - d) nuk është e qartë se për cilin kandidat është votuar;
 - dh) është votuar për një person që nuk është regjistruar si kandidat në fletën e votimit.

Neni 16

Numërimi i votave

1. Mbas përfundimit të votimit, Komisioni fillon numërimin e votave dhe vijon me nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të votimit. Në rast se procesi i votimit është me dy faza, atëherë anëtarët e Komisionit të Votimit njoftojnë për përfundimin e procesit të votimit dhe nxjerrin rezultatin e votimit në fund të çdo faze.
2. Procesi i numërimit të fletëve të votimit dhe i nxjerrjes së rezultatit të votimit është i hapur.
3. Çdo fletë votimi i tregohet anëtarëve të tjerë të Komisionit të votimit dhe të pranishmëve në sallë.
4. Komisioni i votimit vlerëson fillimisht votat e vlefshme dhe pastaj fillon numërimin e tyre.
5. Votat që gjykohen paraprakisht si të pavlefshme rivlerësohen në fund të procesit të numërimit, dhe ato vota që pas rivlerësimit gjykohen të vlefshme u shtohen kandidatëve përkatës.
6. Vendimet e Komisionit të votimit gjatë procesit të numërimit janë përfundimtare.

Neni 17

Hartimi i procesverbalit

1. Në përfundim të procesit të votimit dhe të numërimit të votave (kur votimi zhvillohet me dy faza në përfundim të secilës prej tyre), anëtarët e Komisionit të Votimit hartojnë dhe miratojnë një procesverbal sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kësaj Rregullore, i cili tregon numrin e pjesëmarrësve, numrin total të votave të hedhura, numrin e votave të hedhura për secilën kategori kandidatësh, numrin e votave të pavlefshme, në qoftë se ka të tilla, numrin e votave për çdo kandidat dhe emrat e kandidatëve fitues.
2. Rastet e mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të komisionit të votimit për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre shënohen në procesverbal.
3. Në procesverbal shënohet edhe numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

Neni 18

Shpallja e rezultatit të votimit

Komisioni i votimit, pas përfundimit të numërimit të votave, rendit kandidatët sipas votave që kanë marrë. Në fund të procesit të votimit, quhen të zgjedhur kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave, për secilin pozicion. Në rast se votimi është me dy faza, quhen të zgjedhur kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave, në çdo fazë, për secilin pozicion.

Neni 19

Zgjedhja e kandidatit fitues

1. Në varësi të rezultateve të marra, konsiderohen fitues në votim dhe quhen të zgjedhur anëtarë të KLGJ kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave.
2. Në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 115/2016, në rast se në fazën e dytë tre kandidatë me më shumë vota janë zgjedhur nga gjykatat brenda Tiranës (përfshi atë për Krime të Rënda), vetëm dy kandidatët me më shumë vota do të quhen të zgjedhur. Fituesi i tretë do të konsiderohet kandidati i gjykatës të shkallës së parë jashtë Tiranës që ka marrë numrin më të madh të votave në fazën e parë. Në rast se në fazën e dytë dy kandidatët me më shumë vota janë zgjedhur nga gjykatat e apelit brenda Tiranës (duke përfshirë edhe Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda), vetëm kandidati, me më shumë vota do të quhet i zgjedhur. Fituesi i dytë do të konsiderohet kandidati i gjykatës së apelit jashtë Tiranës, që ka marrë numrin më të madh të votave në fazën e parë.

Neni 20

Shorti për kandidatët me vota të barabarta

1. Në rast se në votimin e parë, dy ose më shumë kandidatë fitues kanë marrë të njëjtin numër votash, për përcaktimin e kandidatit fitues mes tyre organizohet hedhja e shortit.
2. Në presence të të gjithë pjesëmarrësve, një nga punonjësit e administratës së Gjykatës së Lartë i caktuar nga Drejtuesi i Mbledhjes, fut fillimisht nëpër gogla shiritat e letrës që përmbajnë emrat e kandidatëve për të cilët organizohet shorti dhe më pas i vendos ato të gjitha brenda në kuti.
3. Një punonjës tjetër, i caktuar nga Drejtuesi i Mbledhjes, tërheq goglën nga kutia dhe pasi e hap atë, lexon me zë të lartë emrin e anëtarit të Këshillit që përmban shiriti i letrës, duke ia treguar të gjithë pjesëmarrësve, i cili konsiderohet kandidati fitues.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Ndryshimet

1. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen kur votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve.
2. Propozimi për ndryshimet ne Rregullore mund të bëhen nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, ose me kërkesën e 1/10 të anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe miratohen kur votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve.

Dispozita tranzitore

Neni 22

Për efekt të zbatimit të kësaj Rregullore, deri në krijimin e KLGJ, lista e magjistratëve gjyqtarë përgatitet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Rregullorja konsiderohet e miratuar kur votohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të pranishëm të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë në ditën e miratimit të saj nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve.

Kjo Rregullore hyn në fuqi me datë ___/___/2018.

Aneks 1

PROCESVERBAL

Mbi rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarit(ëve) të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Sot më datë ____/____/2018, u zhvillua nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve procesi i votimit për zgjedhjen e anëtarit(ëve) të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit zgjedhor rezultoi si vijon:

Numri i pjesëmarrësve në Mbledhjen e Përgjithshme

Numri total i votave

- Fletë votimi të vlefshme

- Fletë votimi të pavlefshme

Numri i fletëve të votimit që janë zëvendësuar për shkak të dëmtimit.

Nga numërimi i fletëve të votimit të vlefshme, rezultoi se kandidatët morën votat si më poshtë:

KANDIDATËT	VOTAT
I. Gjykata e Lartë	
1.	_____
2.	_____
II. Gjykatat e Apelit	
1.	_____
2.	_____
3.	_____
III. Gjykatat e Shkallës së Parë	
1.	_____
2.	_____
3.	_____

Në bazë të rezultateve të arritura, shpallet(n) fitues kandidati(ët) si vijon:

1. _____ vota (Gjykata e Lartë)
2. _____ vota (Gjykata e Apelit)
3. _____ vota (Gjykata e Apelit)
4. _____ vota (Gjykata e Shkallës së Parë)
5. _____ vota (Gjykata e Shkallës së Parë)
6. _____ vota (Gjykata e Shkallës së Parë)

Rastet e mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të Komisionit të Votimit për vlefshmërinë e votave dhe mënyra e zgjidhjes së tyre.

KOMISIONI I VOTIMIT

K r y e t a r i

(emër mbiemër / firma)

A n ë t a r

(emër mbiemër / firma)

A n ë t a r

(emër mbiemër / firma)